



Fjala e plotë e Kryetarit të KQZ-së, z. Klement Zguri në seminarin, “Forcimi i Transparencës së Zgjedhjeve: Shkëmbimi i përvojave mes Shqipërisë dhe Sllovenisë”.

*Të nderuar Ambasadorë,*

*E nderuar Ambasadore e Republikës së Sllovenisë, zj. Stančič!*

*I nderuar Drejtor i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve Slloveni, zoti Vučko,*

*Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,*

Është kënaqësi që në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t’ju falenderoj të gjithëve për praninë tuaj në këtë seminar që zhvillohet në kuadër të projektit “Forcimi i transparencës së Trupave të Menaxhimit Zgjedhor: Shkëmbimi i përvojave dhe mësimet e nxjerra, mes Shqipërisë dhe Sllovenisë”.

Një falenderim të veçantë adresoj për Ambasadën e Republikës së Sllovenisë, për mbështetjen e këtij projekti, i cili krijoi jo vetëm mundësi bashkëpunimi mes dy insitucioneve homologe, por realizoi një diskutim gjithpërfshirës të faktorëve dhe aktorëve të përfshirë në procesin zgjedhor në Shqipëri, vendosur në kontekst të situatave dhe

zhvillimeve konkrete, si zhvillimi i zgjedhjeve vendore dhe reformës zgjedhore në Shqipëri.

Dy seminarët e parë, të zhvilluar në mars dhe tetor 2015, krijuan mundësinë që konteksti i diskutimeve të lidhej në mënyrë konkrete me ecurinë e procesit zgjedhor në Shqipëri nga fillimi i punës për organizimin e tij e deri në shpalljen e rezultatit.

Seminari i III-të dhe IV-t në 2016, fokusuan trajtimin e temave si: pavarësia e administratës zgjedhore, roli partive politike dhe shoqërisë civile, fushata zgjedhore, vëzhgimi, edukimi qytetar demokratik.

Seminari që zhvillojmë sot trajton një temë e cila ka qenë dhe vijon të jetë sfidë për proceset zgjedhore në Shqipëri, transparencën e procesit të zgjedhjeve.

Të gjithë ciklet e procesit zgjedhor duhet të menaxhohen në transparencë të plotë, çka forcon besimin e publikut në pavarësinë e administratës zgjedhore dhe integritetin e procesit zgjedhor.

Çështje të rëndësishme përgjatë ciklit zgjedhor, si aktet normative me fuqi mbi të gjithë territorin e vendit, caktimi dhe ndarja e mandateve, caktimi i zonave të administrimit zgjedhor, pranimi i ankesave kundër një vendimarrje për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit zgjedhor për një zonë zgjedhore, zgjidhen vetëm nëpërmjet vendimarrjes me një shumicë të cilësuar votash. Çdo vendimarrje e

KQZ-së realizohet në mbledhjet e KQZ-së, të cilat zhvillohen të gjitha të hapura, dhe transmetohen on-line në faqen zyrtare. Materialet për diskutim publikohen elektronikisht 24 orë përpara dhe kushdo mund t'i konsultojë. Vendimet publikohen elektronikisht brenda 24 orëve pas miratimit.

Gjatë numërimit të votave, vendosen kamera që mundësojnë shfaqjen e çdo flete votimi në monitorë dhe regjistrimin/ruajtjen e tyre. Të gjithë paisjet e rregjistrimit që përdoren në Vendet e Numërimit të Votave manaxhohen nga një rrjet kompjuterik i lidhur via-web me serverat e KQZ-së. Përmes Modullit “Rezultatet paraprake”, KQZ manaxhon hedhjen, kontrollin dhe transmetimin e rezultateve nga Vendet e Numërimit të Votave në KQZ. Nëpërmjet një moduli tjetër “Rezultatet e natës së zgjedhjeve”, rezultatet e dërgura elektronikisht në serverin e KQZ-së, publikohen në dinamikë si rezultat paraprak i zgjedhjeve, në sallën e mediave në KQZ dhe në faqen e internetit. Ky proces vazhdon deri në përfundimin e numërimit të votave për çdo zonë zgjedhore.

Baza e të dhënave të rezultateve të krijuara nga transmetimi i rezultateve paraprake shërben për nxjerrjen edhe të rezultatit zyrtar të zgjedhjeve. Saktësia e rezultatit garantohet nga ndjekja e procedurave të miratuara paraprakisht nga KQZ.

Baza logjistike zgjedhore, përgatitet dhe shpërndahet përpara afatit ligjor për çdo komision zgjedhor në të gjithë territorin e vendit.

KQZ gjithashtu ka ndërmarrë një sërë hapash dhe ka miratuar një sërë aktesh nënligjore për të bërë transparencë për financat e partive

politike. Raportet financiare të partive, të monitorimit të fushatës dhe ato të auditëve publikohen dhe bëhen të aksesueshme për publikun në faqen zyrtare të internetit.

Zbatimi i ligjit të dekriminalizimit, gjithashtu bëhet në sytë e publikut. Formularët publikohen në web, ndërsa vendimmarrja bëhet në mbledhjet live.

Pavarësisht punës së mirë të bërë në drejtim të transparencës, gjithmonë ka vend për përmirësim, dhe KQZ-së është i vendosur në të zhvillojë veprimtarinë e tij në mënyrë transparente.

Aktualisht, në Shqipëri është ngritur komisioni i reformës zgjedhore, dhe besoj që propozimet e KQZ-së, ky komision do t'i materializojë në dispozita të reja ligjore, për t'i dhënë KQZ-së, por edhe aktorëve të përfshirë në procesin zgjedhor më shumë autoritet, me qëllim parandalimin e manipulimit strategjik të aspekteve të ndryshme të procesit zgjedhor.

Sikundër është edhe qëllimi i kësaj Konference, vlerësoj se shkëmbimi i eksperiencave, bën që çdo trupë apo administrator zgjedhor të përfitojë ekspertizë për forcimin e integritetit, personal dhe profesional.

KQZ e Shqipërisë, në plan rajonal, ka forcuar bashkëpunimin me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve të Sllovenisë. Konferencat e

zhvilluara në kuadër të projektit të përbashkët për forcimin e pavarësisë së trupave zgjedhore, na kanë shërbyer për shkëmbimin e eksperiencës lidhur me: trajnimin e vazhdueshëm të aktorëve të përfshirë në proceset zgjedhore; përforcimin e dialogut; informimin e vazhdueshëm; rritjen e rolit të gruas në administrimin zgjedhor; bashkëpunimin efektiv me Organizatat Ndërkombëtare; përmirësimin e parametrave të kulturës politike dhe dialogut; përmirësimin dhe thejshtëzimin e procesit të numërimit të votave duke rritur besimin në këtë proces; si dhe për promovimin e transparencës dhe pavarësisë.

Në përfundim një falenderim të veçantë për organizatorët e seminarit, për mundësinë që na japin për tu bërë bashkë e për të shkëmbyer e përfituar nga eksperiencat e ndërsjella!